



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 572/3 Prot

Tiranë, më 15.06.2016

VENDIM

Nr. 32, datë 15.06.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 130, datë 17.05.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 17.05.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë, i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr. 130, datë 17.05.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohet pranë këtij kontrolluesi. Në varësi të këtij kontrolluesi, janë dhe tre Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, të cilat ishin pjesë e inspektimit administrativ.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk ka parashikuar në kontratën me punëmarrësit, (mjekë, laborantë, infermierë apo personel administrativ), Deklaratën e Konfidencialitetit, sipas Vendimit Nr. 6 datë 05.08.2013. Deklarata e Konfidencialitetit, e domosdoshme dhe detyruese jo vetëm për faktin se punëmarrësit mbledhin dhe përpunojnë të dhëna sensitive, por dhe për faktin se, numri i punëmarrësve të kontrolluesit që aksesojnë të dhëna personale në forma të ndryshme, është i konsiderueshëm. Nga verifikimi që ju bë dosjeve të punëmarrësve

- (mjek, infermier, laborant, etj.), nuk rezultonte asnjë deklaratë, apo ndonjë parashikim detyrues në kontratë, mbi konfidencialitetin e punëmarrësit.
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale, përveç rregulloreve me karakter funksional-profesional. Mungesa e rregullave të shkruara në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo departament, qoftë dhe për recepsionin sjell fakte konkrete, si psh: ekspozimi i dokumentave personale të qytetarëve në sportelin e recepsionit, si karta e pacientit që identifikon subjektin e të dhënave nëpërmjet, numrit personal të ID-së, emrit, mbiemrit, etj.
  3. Kontrolluesi nuk ka kontratë me punonjësin e jashtëm IT për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik të A.SH.R-së, për pasojë nuk ka aneks kontratë sipas standardit të Udhëzimit 19, i cili parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke i formalizuar këto të fundit dhe i kthyer ato në efektive. Fakti se ASHR-ja nuk i ka në formë elektronike të dhënat e pacientëve, nuk do të thotë se përjashtohet nga detyrimi i zbatimit të Udhëzimit Nr. 19 datë 03.08.2012, pasi punonjësi i jashtëm ka akses në të dhënat e punonjësve të ASHR-së, dhe është kontraktuar për shërbime shtesë nëse do të paraqitet nevoja, (për krijimin e database-s me të dhënat e pacientëve).
  4. Nga verifikimi që ju bë kartelave të pacientëve në disa qendra komunitare të shëndetit mendor, sidomos tek Qendra Komunitare nr. 2, u konstatua se ambienti që përdorej si kartotekë kryente dhe funksionin e infermierisë. Kartelat e pacientëve të cilat mbartin të dhëna të shëndetit mendor dhe jo vetëm, janë të ekspozuara ndaj individëve të shumtë, si pacientë apo dhe të afërm të tyre.

**Faktet e mësipërme, përbëjnë shkelje administrative të neneve 27, 28 si dhe akteve të Komisionerit, Vendimit Nr. 6, datë 05.08.2013 dhe Udhëzimit Nr. 19 datë 03.08.2012 të tij.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- a- Kontratë me punëmarrësin;
- b- Kontratë shërbimi;
- c- Rregullore bazë e funksionimit të A.SH.R-së;
- d- Pamje nga ambientet e kontrolluesit;
- e- Rregullore e Brendshme, "Për procesin e funksionimit të burimeve njerëzore", të A.SH.R-së.

Në datë 19.05.2016, në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr. 130, datë 17.05.2016 të Komisionerit, u mbajt procesverbali nga ana e grupit të inspektimit të Zyrës së K.D.I.M.D.P-së, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë.

Procesverbali u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se pretendimet do i paraqesin në seancën dëgjimore.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", datë 30.04.2015, në datë 13.06.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit nuk paraqiti pretendime dhe as dokumenta, me të cilat të vërtetohej se ishin përmbushur detyrimet e dala sipas konstatimeve nga grupi i hetimit administrativ, por u shpreh se administrata e kontrolluesit është në proces të përmbushjes së shkeljeve të konstatuara, dhe të pranuar si të tilla nga kontrolluesi.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërmat “ç” dhe “dh” të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, akteve të Komisionerit janë serioze për vetë faktin e përmasës së kontrolluesit, gamës së të dhënave sensitive që ky kontrollues mbledh dhe përpunon. Si të tilla këto shkelje përbëjnë “kundërvajtje administrative” dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

“- ç) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 300 000 lekë.”

“- dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.”

Kontrolluesi, Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave “pacientë”, dhe individëve jo pacientë, të cilët për arsye punësimi, konfirmohen “të aftë” nga ASHR-ja.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 20, 27, 28, 39 paragrafi 1, gërmat “ç”, “dh”, si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

#### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, me gjobë në vlerën **20.000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

4. Dënimin e kontrolluesit *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, (Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 2), me gjobë në vlerën **20.000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
5. Kontrolluesi, *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, të hartojë rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, detyruese këto dhe për qendrat komunitare të shëndetit mendor, si dhe të formalizojë aneks kontratën me përpunuesin, brenda një periudhe prej 30 ditësh.
6. Kontrolluesi, *Autoriteti Shëndetësor Rajonal-Tiranë*, si institucion epror, të marrë masat për sigurimin e të dhënave personale sensitive të pacientëve të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor Nr. 2, Tiranë.
7. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 15.06.2016

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**